



## DOKUMENT

### **E drejta për të votuar e personave me aftësi të kufizuara mendore: Historia, pengesat dhe zgjidhjet e mundshme**

Ky dokument u realizua me fonde të qeverisë suedeze nëpërmjet bashkëpunimit me Civil Rights Defenders, në kuadër të zbatuar në vite nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) "Avancimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara përmes ndihmës juridike strategjike dhe ndërhyrjeve ligjore të qëndrueshme"

Botim i Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Për më shumë information kontaktoni me: Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rruga Bogdani Nr. 15, (Ish. A.Z. Cajupi), Kati III, Tiranë Shqipëri

Tel.: +355 42 69 426

E-mail: [adrf@albmail.com](mailto:adrf@albmail.com)



## I. HYRJE

Sot e drejta për të votuar ende i mohohet për personat me aftësi të kufizuara mendore përmes dispozitave të ndryshme ligjore të përfshira në Kushtetutë, kode zgjedhore apo ligje të tjera. Për vite të tëra ka pasur një diskutim në rritje në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe të drejtën për të votuar.

Perceptimi dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuara është ende i lidhur ngushtë me një pikëpamje të vjetruar të kulturës dhe shoqërisë. Është pranuar në mënyrë universale që segregimi ose izolimi i personave me aftësi të kufizuara është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.<sup>1</sup>

Diskursi ka përfshirë të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe ndërkohë që mund të vërehet përmirësim i pjesshëm në aksesin fizik, progresi është ende i ngadaltë dhe i pamjaftueshëm për personat me aftësi të kufizuara shqisore, por njëkohësisht ka edhe një grup personash me aftësi të kufizuara të cilëve u është kushtuar një vend edhe më i vogël në këtë diskurs që ka të bëjë me të drejtën për të votuar. Këta janë personat me aftësi të kufizuara mendore. Aftësia e personave me aftësi të kufizuara shpeshherë vihet në pikëpyetje. Sipas shumicës së sistemeve ligjore, e drejta për të votuar lidhet me kapacitetin ligjor<sup>2</sup> të personave, e cila nga ana tjetër është e lidhur me aftësinë ose kapacitetin e personit.

Për shkak të stigmës dhe paragjyimit të krijuar gjatë shekujve, personat me aftësi të kufizuara mendore ende konsiderohen si 'të paaftë' për të kuptuar të drejtat e tyre ose cilat pasojat që mund t'u sjellin atyre. Kjo përfshin të drejtën e votës, e cila mohohet për shkak të mohimit të kapacitetit ligjor të personave me aftësi të kufizuara mendore.

Personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri, sikurse në shumë vende të tjera hasin në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike pengesa të shumëllojshme në ushtrimin e të drejtën së tyre për të votuar. Numri i votueseve me aftësi të kufizuara nuk është zyrtarisht i deklaruar. Megjithatë, duke iu referuar

---

<sup>1</sup> Thematic study on the right of persons with disabilities to live independently and be included in the community; Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights

[http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session28/Documents/A\\_HRC\\_28\\_37\\_ENG.doc](http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session28/Documents/A_HRC_28_37_ENG.doc)

<sup>2</sup> Ky koncept është përkthyer nga Legal Capacity, e cila përfshin zotësinë juridike sëbashku me zotësisë juridike për të vepruar.

statistikave të marra nga INSTAT mbi grup moshat e popullsisë<sup>3</sup> mund të konstatohet se janë afërsisht 134 mijë persona me aftësi të kufizuara në moshë votimi. Nëse llogarisim edhe pjesëtarë të familjeve të personave me aftësi të kufizuara me të drejtë vote, potenciali i tyre për të ndikuar në vendimmarrje përmes mekanizmit të votës rritet disa herë.<sup>4</sup>

Raporti i vëzhgimit " E drejta e zgjedhësve me aftësi të kufizuara dhe rezultatet e vëzhgimit për Zgjedhjet Parlamentare"realizuar në vitin 2017 nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e

Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) megithëse identifikoi rritje të ndërgjegjësimit të institucioneve në lidhje me të drejtën për të votuar të personave me aftësi të kufizuara, identifikoi njëkohësisht pengesa të cilat kishin të bënin me kuadrin ligjor ekzistues i cili vazhdon të mbetet jogjithëpërfshirës dhe i paplotë, zbatimin e ulët të tij, dhe gjithashtu mungesën e ndërgjegjësimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Sikurse konfirmojnë edhe raporte të tjera të zhvilluara nga FSHDPAK përgjatë viteve të shkuara, progresi i rregjistruar në drejtim të kapërcimit të këtyre pengesave është i pamjaftueshëm. Këto pengesa kishin të bënin me qendra votimi të përshtatura, mosvendosje të tyre në katet e para apo mungesë rampash, mungesë e fletëve të përshtatura të votimit, mungesë të dhomës së është të përshtatur për përdoruesit e karrigeve me rrota, mungesë interpretësh në gjuhën e shenjave për persona që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin, por edhe me dispozitat ligjore që ndalojnë votimin e personave me aftësi të kufizuara mendore, në kushtet e një vendimi gjyqësor të një forme të prerë të heqjes së zotësisë juridike për të vepruar.

## II. METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është hulumtimi mbi të drejtën e votës të personave me aftësi të kufizuara mendore në kuadrin e zhvillimeve të fundit, sidomos risive që sjell Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Kjo e drejtë ka marrë një kuptim të ri dhe modern, në përputhje me të gjitha risitë që sjell KDPAK, veçanërisht neni 12: "Njohja përpara ligjit" e personave me aftësi të kufizuara. Neni 12 është një nga nenet më të debatuar të KDPAK-së. Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar ka nxjerrë tashmë një Koment të Përgjithshëm mbi nenin 1 që përpiqet të sqarojë dhe të japë udhëzime të detajuara se si duhet të kuptohet dhe të zbatohet ky nen nga vendet që kanë ratifikuar KDPAK, duke përfshirë edhe ndikimin dhe zbatimin e tij në të drejtën për të votuar.

Një qëllim tjetër i këtij dokumenti është që të ndërgjegjësojë institucionet qendrore dhe vendore për problemet e vazhdueshme me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara sa herë ata ushtrojnë të

---

<sup>3</sup> Censusi i Popullsisë dhe Banesave, 2011

<sup>4</sup> Raporti i vëzhgimit " E drejta e zgjedhësve me aftësi të kufizuara dhe rezultatet e vëzhgimit për Zgjedhjet Parlamentare"realizuar në vitin 2017 nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK)

drejtën e tyre për të votuar. Ky dokument i shërben këtyre institucioneve për të reflektuar dhe për të marrë masa për eliminimin e pengesave.

E drejta për të votuar hulumtohet përgjatë dokumentit në këtë kontekst, së bashku me të drejtën për njohje të barabartë përpara ligjit dhe disa nga parimet kryesore të KDPAK-së. Dokumenti do të evidentojë zhvillimet që janë arritur deri më tani në të drejtën ndërkombëtare lidhur me të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara mendore.

Për të arritur këtë qëllim, dokumenti hulumton natyrën e të drejtës së votës dhe karakterin e saj universal nëpërmjet analizimit të zhvillimit historik të kësaj të drejte duke filluar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut<sup>5</sup>, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike<sup>6</sup>, Komenti i Përgjithshëm mbi Nenin 25 të KNDCP<sup>7</sup>, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>8</sup>, jurisprudenca e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>9</sup>, jurisprudenca e zhvilluar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>10</sup>.

Për hartimin e këtij dokumenti u përdor një metodologji cilësore. U analizuan një sërë dokumentash kombëtarë dhe ndërkombëtarë. U zhvilluan gjithashtu dhe disa intervista me ekspertë për çështjet të personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjes së tyre në proceset zgjedhore.

---

<sup>5</sup> Universal Declaration of Human Rights, 1948

<http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

<sup>6</sup> International Covenant on Civil and Political Rights <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx>

<sup>7</sup> General Comments under article 40, paragraph 4 of the International Covenant on Civil and Political Rights General Comment No. 25, 1996

[http://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CCPR%2fC%2f21%2fRev.1%2fAdd.7&Lang=en](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CCPR%2fC%2f21%2fRev.1%2fAdd.7&Lang=en)

<sup>8</sup> Convention on the Rights of Persons with Disabilities, 2006

<http://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>

<sup>9</sup> Committee on the Rights of Persons with Disabilities, Communication No. 4/2011

[http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CRPD/Jurisprudence/CRPD-C-10-DR-4-2011\\_en.doc](http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CRPD/Jurisprudence/CRPD-C-10-DR-4-2011_en.doc)

<sup>10</sup> The European Court of Human Rights, case Alajos Kiss v. Hungary, Strasbourg, 2010

<http://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=001-98800&filename=001-98800.pdf&TID=nlznbgtpxd>

### III. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TË DREJTËN PËR TË VOTUAR

Një nga rregullat më të artikuluar të së drejtës ndërkombëtare është e drejta për të marrë pjesë në politike dhe jetën publike. Ajo është njëkohësisht një nga të drejtat më shpesh të mohuara për personat me aftësi të kufizuara. Përrjashtimet nga pjesëmarrja politike dhe publike të personave me aftësi të kufizuara kanë shumë arsye dhe marrin shumë forma. Ato ndikojnë negativisht dhe shkaktojnë shkelje të tjera të të drejtave të njeriut.<sup>11</sup>

Ekzistojnë dy arsye kryesore që e bëjnë të drejtën për të votuar themelore, veçanërisht në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Sipas Ëaterstone votimi nuk është thjesht një instrument në duart e qytetarit për të zgjedhur një kandidat, por është gjithashtu një mënyrë në të cilën qytetari krijon vendin e vet në komunitet. Sipas Fishkin votimi është i lidhur me dinjitetin njerëzor. Është dinjiteti që e trashëgon në idenë që "vota ime" numërohet pikërisht si "votat tuaja" (të të tjerëve) dhe që "unë jam" i barabartë.<sup>12</sup>

Në këtë kontekst pikërisht përrjashtimi nga votimi përbën një "dëm në dinjitetin e njeriut", i cili mund të shumëfishohet kur personi nuk "përrfilllet" si qytetar i plotë dhe i barabartë në kontekste të tjera në shoqëri, pra në rastin konkret, kur personat me aftësi të kufizuara trajtohen në mënyrë pabarabartë.

Megjithatë, deri më tani, vëmendje shumë e vogël i është kushtuar të drejtës për të votuar të personave me aftësi të kufizuara mendore. Vëmendja është përqendruar në vlefshmërinë dhe shtrirjen e përrjashtimeve nga e drejta për të votuar e personave me aftësi të kufizuara dhe nuk është parë ndonjëherë nga një qasje pozitive se si t'i mundësojnë personat me aftësi të kufizuara që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar.<sup>13</sup>

---

<sup>11</sup> Facilitating an Equal Right to Vote for Persons with Disabilities JANET E. LORD, MICHAEL ASHLEY STEIN AND JA' NOS FIALA-BUTORA, Journal of Human Rights Practice Vol. 6 | Number 1 | March 2014  
[http://bbi.syr.edu/nees\\_events/nees/2014/04/Voting\\_Inclusion.pdf](http://bbi.syr.edu/nees_events/nees/2014/04/Voting_Inclusion.pdf)

<sup>12</sup> Everybody counts: The right to vote of persons with psychosocial disabilities in South Africa, Heléne Combrinck  
[http://www.adry.up.ac.za/images/adry/volume2\\_2014/adry\\_2014\\_2\\_chapter4.pdf](http://www.adry.up.ac.za/images/adry/volume2_2014/adry_2014_2_chapter4.pdf)

<sup>13</sup> The right to political participation of persons with mental health problems and persons with intellectual disabilities, October 2010, <http://fra.europa.eu/en/publication/2010/right-political-participation-persons-mental-health-problems-and-persons>

#### **IV. SI ËSHTË ZHVILLUAR KJO E DREJTË NË LEGJISLACIONIN NDËRKOMBËTAR TË PËRZGJEDHUR?**

##### **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut**

Një nga dokumentet klasike të të drejtave të njeriut, me deklaratë të forta mbi vlerat universale të shoqërisë njerëzore është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), e cila shënon kthesë në historinë e të drejtave të njeriut. Pohimet në këtë deklaratë konsolidojnë idetë dhe formësojnë të menduarit e mëvonshëm mbi të drejtat e njeriut<sup>14</sup>.

Ndërmjet shumë të drejtave të përfshira në këtë dokument, e drejta për të votuar gjendet në nenin 21:

1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Gjithkush ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.
3. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.<sup>15</sup>

Personat me aftësi të kufizuara nuk përmenden në mënyrë të drejtëpërdrejtë në DUDNJ. Megjithatë, neni 2 i deklaratës siguron që neni 21 gëzohet dhe ushtrohet në baza të barabarta, pa diskriminim. Në atë kohë, për shkak të rrethanave, shumë vëmendje i është kushtuar karakterit universal dhe të lirë të së drejtës për të votuar<sup>16</sup>.

##### **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike**

Neni 25 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) thekson se:

---

<sup>14</sup> Elkins, Zachary and Ginsburg, Tom and Melton, James, *Imagining a World Without the Universal Declaration of Human Rights* (March 8, 2014). Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2469194> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2469194>

<sup>15</sup> Universal Declaration of Human Rights, 1948 <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

<sup>16</sup> The universal Declaration of Human Rights: Origins, Drafting, and Intent, Johannes Morsink, 1999. [https://books.google.com/books?id=nSËZY3Rs9vQC&pg=PA264&lpg=PA264&dq=commentary+article+21+UDHR&source=bl&ots=VnCoddacëU&sig=gXzzGzrzkers09x-DË73Mëëy8rc&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEëiK2o\\_PuObËAhËf14MKHRANDS44FBD0AQhAMAU#v=onepage&q=article%2021&f=false](https://books.google.com/books?id=nSËZY3Rs9vQC&pg=PA264&lpg=PA264&dq=commentary+article+21+UDHR&source=bl&ots=VnCoddacëU&sig=gXzzGzrzkers09x-DË73Mëëy8rc&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEëiK2o_PuObËAhËf14MKHRANDS44FBD0AQhAMAU#v=onepage&q=article%2021&f=false)

Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;
- (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.

Neni 25 përdor gjuhë të ngjashme me atë të nenit 21 të DUDNJ-së. Në vend të "të gjithë" është "çdo qytetar". Dhe çfarë përbën interes për qëllimin e këtij dokumentin shtohet shprehja "pa kufizime të arsyeshme".

Më shumë informacion për shprehjen "pa kufizime të arsyeshme" gjendet në komentin e përgjithshëm nr. 25 (57), paragrafi 4<sup>17</sup>. "Çdo kufizim që zbatohet për ushtrimin e të drejtave të mbrojtura nga neni 25 duhet të bazohet në kritere objektive dhe të arsyeshme. Për shembull, mund të jetë e arsyeshme të kërkohet një prag më i lartë moshe për zgjedhje ose emërim në poste të caktuara. Ushtrimi i këtyre të drejtave nga qytetarët nuk mund të pezullohet ose përjashtohet përveçse në raste të caktuara me ligj dhe të cilat janë objektive dhe të arsyeshme. Për shembull, aftësia e kufizuar mendore mund të jetë bazë për mohimin e një personi të drejtën për të votuar ose për të mbajtur detyrën."

Nga DUDNJ, KNDCP dhe Komenti i Përgjithshëm, e drejta për të votuar për personat me aftësi të kufizuara mendore duket të jetë kufizuar nga njëri dokument në tjetrin. Megjithatë, siç do të shpjegohet më poshtë, e drejta nuk ka qenë atje që nga fillimi.

Diskutimet në Nenin 6 të DUDNJ-së tregojnë se ka pasur një kuptim të qartë të të gjithë aktorëve pjesëmarrës në hartimin e këtij dokumenti se personat me aftësi të kufizuara mendore nuk njihen para ligjit, dmth. kanë të drejta, por nuk mund t'i ushtrojnë ato. Edhe pse duket nga këto dokumente se e drejta për të votuar ka humbur me kohën karakterin e saj 'universal', në fakt mund të mos e ketë pasur kurrë.

---

<sup>17</sup> UN Human Rights Committee (HRC), CCPR General Comment No. 25: Article 25 (Participation in Public Affairs and the Right to Vote), The Right to Participate in Public Affairs, Voting Rights and the Right of Equal Access to Public Service, 12 July 1996, CCPR/C/21/Rev.1/Add.7, available at: <http://www.refworld.org/docid/453883fc22.html> [accessed 19 October 2017]

#### **IV. MOHIMI I KAPACITETIT LIGJOR<sup>18</sup> DHE E DREJTA E VOTIMIT**

Kapaciteti ligjor si parakusht për ushtrimin e të drejtave:

Vendimarrja është thelbësore për autonominë e një personi dhe përbën thelbin e asaj që konsiderohet si "personaliteti i njeriut". Ajo është një faktor vendimtar në aftësimin e njerëzve për të pasur kontroll mbi jetën e tyre dhe për t'u angazhuar me shoqërinë. Pa aftësinë për të marrë vendime për veten tonë, ne nuk konsiderohemi si persona para ligjit dhe veprimet dhe vendimet tona nuk kanë më fuqi ligjore.

Në rrethana të tilla, palët e treta në cilësinë e kujdestarëve shpesh marrin vendime në emër të personave që nuk kanë kapacitet ligjor, qoftë edhe joformalisht (përkatesisht një i afërm) ose formalisht (një kujdestar ose institucion i caktuar nga gjykata)

Personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të vazhdueshme janë rrezik "të zhvishen" nga aftësitë e tyre vendimarrëse dhe të drejtën për të marrë vendime, ku të tjerë marrin vendime për ta. Në mënyrë të veçantë, prania e një diagnoze mendore shpesh barazohet me mungesën e aftësisë për të marrë vendime. Shoqëria ka kufizuar historikisht vendimarrjen e personave me aftësi të kufizuara mendore për shkak të aftësisë së kufizuar.

Si rezultat i kësaj qasjeje, institucionet "janë kujdesur" për personat me aftësi të kufizuara mendore duke i hequr atyre autonominë, përgjegjësinë dhe vetëvendosjen. Duke vendosur personat me aftësi të kufizuara mendore nën kujdestari, i hiqen atyre të drejtat për të vendosur. Kjo nënkupton heqjen e mundësisë për të realizuar në transaksione ose nënshkruar kontrata, shitur, blerë, martuar, punësuar e të tjera.<sup>19</sup>

Kapaciteti ligjor mund të përshkruhet si fuqia ose mundësia e një personi për të vepruar brenda një sistemi ligjor. Me fjalë të tjera, personi është subjekt para ligjit. Është një koncept ligjor, një konstrukt, i caktuar për personat në moshë madhore, që u mundëson atyre të kenë të drejta dhe detyrime, të marrin vendime dhe t'i respektojnë ato. Disa juridiksione bëjnë dallim mes të aftësisë për të pasur të drejta dhe aftësisë për të vepruar ose për t'i ushtruar këto të drejta. Pjesa e parë përfshin të drejtën për të qënë subjekte para ligjit; për shembull e drejta për të pasur një pronë apo pasuri, të ketë drejtat e njeriut dhe të drejta të tjera të parashikuara nga legjislacioni. Pjesa e dytë (për të ushtruar të drejtat) shkon më tej dhe përfshin ushtrimin e tyre (dmth. persini përveçse të ketë të drejtën për të patur një pronë, t'a përdorë atë, ta shesë, ta japë me qira dhe të tjera) dhe të kërkojë të drejtat e tij në gjykate<sup>20</sup>.

---

<sup>18</sup> Përkthim nga Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Përfshin zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar sipas kësaj konvente.

<sup>19</sup> Pathare S, Shields LS. Supported decision-making for persons with mental illness: a review. *Public Health Reviews*. 2012 [http://supporteddecisionmaking.com/sites/default/files/pathare\\_2012.pdf](http://supporteddecisionmaking.com/sites/default/files/pathare_2012.pdf)

<sup>20</sup> Who get to decide? Right to legal capacity for persons with intellectual and psychosocial disabilities; 2012 Commissioner for Human Rights/Issue Paper (2012)2 Original version



Modeli më i hershëm, ai binar, shihte aftësinë e kufizuar si një defekt që privonte një individ nga aftësia apo kapaciteti dhe rrjedhimisht nga e drejta ligjore për të bërë zgjedhje. Kështu, në kohën e hershme në legjislacionin anglez kujdestaria iu imponua personave të shpallur "idiotë" ose " të çmenduri".<sup>21</sup> Me përparimet në mjekësi dhe zhvillimin e psikiatrisë dhe psikologjisë, kushtet që shkaktonin vendosjen nën kujdestari u "medikalizuan" dhe përcaktimi i "paaftësisë" u zhvendos tek personat që merrnin vendime mjekësore në bazë të diagnozës, pra mjekët kryesisht <sup>22</sup>.

Nga gjysma e dytë e shekullit të njëzetë, ky model mori një qasje funksionale. Kjo qasje e shihte aftësinë e personit si diçka që në thelb ishte konjitive dhe kuptonte aftësinë e kufizuar si paaftësi për të kuptuar informacionin që lidhet me marrjen e një vendimi dhe për të kuptuar pasojat e mundshme të marrjesose jo të vendimit<sup>23</sup>. Sipas kësaj qasjeje, kapaciteti i personit mund të jetë i ndryshëm në kohë dhe në vendimet fusha të ndryshme vendimarrjeje. Ky model, i cili mund të vendosjen e personit nën kujdestari të plotë ose të pjesshme përdoret gjerësisht në shtete të ndryshme <sup>24</sup>.

Arsyet kryesore për këtë situatë ishin a) brishtësia e moshës dhe mungesa e përvojës dhe neglizhimi i mundshëm dhe b) problemet mendore si pasojë e një sëmundjeje. Në rastet kur aftësia ligjore ishte e kufizuar për shkak të moshës, kufizimi ishte i pjesshëm, ndërsa në rastin e problemeve mendorekufizimi ishte i plotë. Në problemet mendore përfshihej 'çmenduria akute', ose tërbimi (furia) dhe problemet zhvillimore (të quajtura dementia).<sup>25</sup>

Personat e tillë konsideroheshin si persona të cilët nuk mund të jepnin vullnetin e tyre, nuk mund të ndërmerinin detyrime, nuk mund të jepnin pëlqimin e tyre, qoftë në rolin e një kreditori apo debitori, nuk i kuptonin pasojat e veprimeve, sepse ata nuk kishin intelekt (intellectus) dhe gjykimi. Në një farë mase, përkundër shumë zhvillimeve të rëndësishme ligjore në fushën e të drejtave të aftësisë së kufizuar gjatë shekullit të kaluar, mungesa e përkufizimeve të qëndrueshme në fushën e aftësisë së kufizuar mendore është një pengesë e madhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e votës.

---

<https://rm.coe.int/16806da5c0>

<sup>21</sup> Terminologji kjo e cila nuk përdoret më, por që përdoret në dokument për efekt të përshkrimit të historisë.

<sup>22</sup> [ARTICLE: CHANGING PARADIGMS: MENTAL CAPACITY, LEGAL CAPACITY, GUARDIANSHIP, AND BEYOND, 44 COLUM. HUMAN RIGHTS L. REV. 93](#)

<sup>23</sup> [Ibidem.](#)

<sup>24</sup> [Ibidem.](#)

<sup>25</sup> Wayne Martin, Matt Burch, Project Essex: Does the MCA recognize legal capacity on an equal basis? 2014

<http://autonomy.essex.ac.uk/ep-content/uploads/2014/06/3.-Briefing-Paper-Three-FINAL.pdf>

Aftësitë e kufizuara mendore shpesh vendosen në disa kategori të ndryshme si për shembull sëmundjet mendore, aftësitë e kufizuara në zhvillim, çrregullimet në sjellje apo të komunikimit. Këto kategori, nuk konsiderohen sit ë besueshme pasi një aftësi e kufizuar mund të mos përshtatet mirë ose plotësisht brenda njëres ose tjetrës kategori. Pavarësisht këtyre dallimeve apo kategorizimit, çdo lloj i aftësisë së kufizuar mendore në përgjithësi trajtohet në mënyrë të ngjashme në kontekstin e ligjit<sup>26</sup>.

Disa nga arsyet e legjislacionit i cili i privon personat m aftësi të kufizuara nga e drejta për të votuar janë: Së pari, që personat me sëmundje mendore konsideroheshin se nuk kishin ' intelekt'. Kjo i përjashtoi ata nga pjesëmarrja në shoqëri ose në nisma qytetare, duke pasur parasysh vendosjen e theksit tek racionaliteti si thelbi i qytetarisë demokratik. Një tjetër arsye kishte të bënte me partitë politike të cilat heqjen e të drejtës për të votuar të personave me aftësi të kufizuara mendore e perceptonin si një avantazh. Është interesante se miratimi i ligjeve të tilla shpesh përputhej me ndërtimin e 'azileve' për personat me aftësi të kufizuara mendore me idenë për të kontrolluar rezultatin e zgjedhjeve lokale.<sup>27</sup>

Arsyeja më bashkëkohore për heqjen e së drejtës për të votuar të personave me aftësi të kufizuara mendore nga votimi janë "ruajtje e bashkësisë politike"<sup>28</sup> ose "ruajtja e integritetit të procesit zgjedhor"<sup>29</sup>, si dhe parandalimi i mashtrimit të votuesve. Me aftësi të kufizuara mendore. Këto ide presupozojnë se bashkësia politike do të ruhet duke bërë një dallim midis votuesve që synojnë të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve përmes shprehjes së disa preferencave dhe atyre që nuk e kuptojnë natyrën e votimit dhe nuk janë në gjendje të votojnë me kompetencë. Siç u përshkrua pak më lart, këto ide brenda kontekstit të së drejtës civile mund të gjurmohen në origjinën e ligjeve të kujdestarisë dhe vullnetit në Romën e lashtë. Asokohe, prania e një aftësie të kufizuar mendore ishte e mjaftueshme për të mohuar të drejtat dhe privilegjet individuale të vendimarrjes, por sot ligjvënësit kanë filluar ta kuptojnë se kompetenca është një koncept me shumë nuanca dhe na bazë të kësaj, juridiksione të ndryshme po kërkojnë gjithnjë e më shumë gjykimin e kompetencës para se të drejtat të mohohen.

Në shumicën e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian e drejta e pjesëmarrjes politike lidhet me kapacitetin ligjor (zotësinë juridike për të vepruar) të individit. Këto shtete kanë një dispozita ligjore të cilat përjashtojnë në mënyrë automatike personat me aftësi të kufizuara mendore nga pjesëmarrja. Ata mohojnë të drejtën e pjesëmarrjes politike për të gjithë personat nën një masë mbrojtëse siç është kujdesi i

---

<sup>26</sup> Ryan Kelley, Toward an Unconditional Right to Vote for Persons with Mental Disabilities: Reconciling State Law with Constitutional Guarantees, 30 B.C. Third World L.J. 359 (2010), <http://laedigitalcommons.bc.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1019&context=telj>

<sup>27</sup> Ibidem.

<sup>28</sup> The right to political participation of persons with mental health problems and persons with intellectual disabilities, October 2010, <http://fra.europa.eu/en/publication/2010/right-political-participation-persons-mental-health-problems-and-persons>

<sup>29</sup> Ibid.



pjesshëm dhe i plotë, pavarësisht nga niveli i tyre i aftësisë funksionale ose pavarësisht faktit nëse kanë aftësi të kufizuar intelektuale apo një problem të shëndetit mendor.

### **Kufizimet në të drejtën për të votuar**

Në dokumentin e titulluar "Statusi ndërkombëtar i të drejtës për të votuar" të përgatitur nga Alexander Kochion, Projekti i Koalicionit të Demokracisë, autori përmbledh kufizimet kryesore për të drejtën e votës.<sup>30</sup>

E drejta për të votuar domosdoshmërisht mund të ketë disa kufizime. Zakonisht këto kufizime gjenden në kushtetutë ose në ligje që rregullojnë zgjedhjet Përtej shembujve kufizimeve që kanë të bëjnë me pasjen e nënshkëmbësish dhe arritjen e një pragu të caktuar moshe, ligjet shpesh ndalojnë në mënyrë eksplicite të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje nga ata që konsiderohen të paafte mendërisht dhe/ose nga të burgosurit. Llojet e kufizimeve mund të përmbledhen në tre kategori të përgjithshme:

- 1) Kufizimet në bazë të anëtarësisë në komunitet Shembuj: shtetësia, vendbanimi, gjuha
- 2) Kufizimet në bazë të kompetencave ose autonomisë Shembuj: mosha, shëndeti mendor
- 3) Kufizimet si formë dënimi Shembuj: burgim, mashtrim në zgjedhje, tradhti kombëtare.

Kufizimet e përmbledhura më sipër kanë qënë gjithmonë të pranishme në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, pavarësisht faktit se ka pasur ndryshime. Megjithatë, ato që janë të vlefshme për këtë dokument janë kufizimet e bazuara në kompetencën mendore. Në këtë kuptim, vlen të theksohet se si e drejta e njohjes para ligjit (kapaciteti ligjor) është futur në dokumente të tilla themelore si DUDNJ dhe KNDCP për të kuptuar më tej ndërvarësinë e të drejtës për të votuar dhe të drejtën për njohje para ligjit.

Për të kuptuar këtë ndërvarësi është e rëndësishme që të qartësohet koncepti i kapacitetit ligjor nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare.

Nuk mund të gjendet një përkufizim i qartë dhe i mirënjohur i konceptit të kapacitetit ligjor edhe pse në vitet e fundit, veçanërisht pas hyrjes në fuqi të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka pasur përpjekje serioze për ta përcaktuar atë.

Përdorimi i parë i së drejtës për 'njohje të barabartë para ligjit' gjendet në nenin 6 të DUDNJ-së, i cili parasheh që "Gjithkush ka të drejtë të njihet kudo personalitet juridik". Nga historiku i diskutimeve rezulton se qëllimi kryesor i këtij neni ishte të siguronte ushtrimin e disa të drejtave themelore civile duke

---

<sup>30</sup> The International Status of the Right to Vote prepared by Alexander Kirshner Democracy Coalition Project  
<http://archive.fairvote.org/media/rtv/kirshner.pdf>

përfshirë të drejtën për të lidhur një kontratë, për të ngritur një kërkesë-padi, për të blerë ose shitur një send<sup>31</sup>.

Megjithatë, këto diskutime, nuk kanë sqaruar ndonjëherë nëse ky nen përfshin zitëosë juridike apo zotësinë juridike për të vepruar. Por literatura thekson se aftësia për të pasur të drejta nuk mund të ngatërrohet me "aftësinë" për të ushtruar këto të drejta. Të miturit ose personat me aftësi të kufizuara<sup>32</sup> mendore, padyshim sipas nenit 6, kanë të drejtën e pronës, por për shkak të mungesës së kapacitetit mendor veprimet që mund të kryejnë me to janë të kufizuara. Ky mendim nuk u konsiderua në atë kohë në kundërshtim me natyrën universale të vetë nenit 6.

KNDCP vazhdon të mbështesë këtë mendim të zhvilluar sipas nenit 6 të DUDNJ-së për të drejtën e votimit të personave me aftësi të kufizuara mendore. Kufizimi i së drejtës për të votuar bazuar në kapacitetin mendor lejohet për sa kohë që kjo është objektive dhe e arsyeshme.

Por me zhvillimet më të fundit, kapaciteti ligjor ka marrë një kuptim tjetër në konventat ndërkombëtare dhe në diskursin e nxitur nga lëvizja e personave me aftësi të kufizuara. Kapaciteti ligjor këtu i referohet si aftësisë së njerëzve për të pasur të drejta në baza të barabarta me të tjerët dhe për të pasur aftësinë për të vepruar dhe për të njohur veprimet e tyre me ligj<sup>33</sup>.

### **Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara**

Manuali mbi të Drejtat e Njeriut të Personave me Aftësi të Kufizuara nga Marianne Schulze shpjegon procesin e hartimit të nenit 29 për të drejtën e pjesëmarrjes publike dhe politike.

Formulimi i përdorur në KDPAK është më i drejtpërdrejtë se "do të të garantojë" duke e krahasuar me "garanton të drejtën". Vihet re se dispozitat mbi "votimin universal dhe të barabartë" dhe "zgjedhjet autentike periodike", të cilat mund të gjenden në Nenin 5 (c) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Nenit 25 (b) KNDCP përkatësisht, nuk përfshihen në Konventë<sup>34</sup>.

---

<sup>31</sup> The Universal Declaration of Human Rights: A Common Standard of Achievement Guðmundur S. Alfreðsson, Asbjørn Eide, 1999 <https://books.google.al/books?id=FmuoB-BIMvEC&pg=PA234&lpg=PA234&dq=interpretation+article+6+of+universal+declaration+of+human+rights&source=bl&ots=A7BjoGgL3Q&sig=Lzo7rfdULscf-TMOëzUDCDcv-xg&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEëiKltCfm-vKAhUqmHIKHbAZAY84ChDoAQg8MAY#v=onepage&q=article%206&f=false>

<sup>32</sup> Ibid.

<sup>33</sup> Article: changing paradigms: mental capacity, legal capacity, guardianship, and beyond, 44 colum. human rights l. rev. 93

<sup>34</sup> A Handbook on the Human Rights of Persons C Disabilities Marianne Schulze, 2010

[http://www.hiproëeb.org/uploads/tx\\_hidrtdocs/HICRPDManual2010.pdf](http://www.hiproëeb.org/uploads/tx_hidrtdocs/HICRPDManual2010.pdf)

Neni 29 i KDKPAK përmban si në vijim:

Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër: (a) Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar mpjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke: (i) Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur; (ii) Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, ne rastet e përshtatshme; (iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistencë në votim nga një person i zgjedhur prej tyre. (b) garantimin e një ambjenti, në të cilin personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimin e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë: 25 (i) Pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike; (ii) Krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

Ndërsa në dokumentet e mëparshme si DUDNJ (kryesisht diskutimet në nenin 6) KNDCP dhe në mënyrë specifike Komenti i Përgjithshëm 25, lenë të kuptojnë se kufizimi i të drejtave në bazë të aftësisë së kufizuar nuk bie ndesh me karakterin universal të të drejtave, është e qartë se neni 29 i KDKPAK nuk parashikon ndonjë kufizim në të drejtën e votës.

Duhet të pranohet që shumë ligje kanë ndryshuar në mënyrë rrënjësore që nga miratimi i komentit të përgjithshëm të Komitetit të të Drejtave të Njeriut në vitin 1996 për nenin 25 të KNDCP. Sot mund të argumentohet se shumica e kufizimeve të votimit "nuk janë më në përputhje me ndalimin e diskriminimit në nenet 2, par. 1 dhe komentin 25 të KNDCP ose me kuptimin e sotëm të demokracisë. Kjo vlen, në veçanti, në lidhje me kufizimet e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në bazë të aftësive të kufizuara mendore<sup>35</sup>.

---

35 Thematic study by the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights on participation in political and public life by persons with disabilities

<http://www.ohchr.org/EN/Issues/Disability/Pages/ParticipationPoliticalAndPublicLife.aspx>

Nenet 1 dhe 29 të KDPAK-së garantojnë të drejtën aktive dhe pasive për të votuar personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe personat me probleme të shëndetit mendor. Në mungesë të një interpretimi autoritativ të këtyre neneve nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ende nuk është e mundur një interpretim përfundimtar.

Megjithatë, mund t'i referohemi vendimit të Komitetit ku ka sqaruar qëndrimin në lidhje me të drejtën për të votuar të personave me aftësi të kufizuara mendore<sup>36</sup>.

Personat që paraqesin ankesën para Komitetit ankohen konkretisht për mënyrën se si persona nën kujdestari ligjore, me anë të zbatimit të drejtpërdrejtë të nenit 70 (5) të Kushtetutës, fshihen automatikisht nga regjistrat zgjedhorë. Vendimet e gjykatës të cilat i vendosnin ata nën kujdestari, pasi hiqnin zotësin për të vepruar, nuk adresonin aftësinë e tyre për të votuar. Ankuesit argumentojnë se ata janë në gjendje të kuptojnë proceset politike, programet dhe të marrin pjesë në zgjedhje nëse u lejohej dhe deklarojnë se ky ndalim në Kushtetutë është i pajustificuar dhe shkel nenin 29. Komiteti arriti në përfundimin që neni i Kushtetutës që ndlonte votimin nga persona me aftësi të kufizuara mendore ishte në kundërshtim me nenin 29 dhe në lidhje me nenin 12 të Konventës.

Komiteti kujton që neni 29 i Konventës kërkon që shtetet palë të sigurojnë që personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në jetën politike dhe publike në baza të barabarta me të tjerët, duke garantuar të drejtën e tyre për të votuar. Neni 29 nuk parashikon ndonjë kufizim të arsyeshem, as nuk lejon ndonjë përjashtim për ndonjë grup të veçantë personash me aftësi të kufizuara. Prandaj, përjashtimi i të drejtës për të votuar në bazë të një aftësie të kufizuar të perceptuar ose apo ekzistuese, të shëndetit mendor ose intelektuale, duke përfshirë edhe përjashtimet që vijnë si pasojë kufizim e një vlerësimi të individualizuar, përbëjnë diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar. Komiteti më tej sqaron sipas nenit 12 paragrafi 2 të Konventës, shtetet palë duhet të njohin dhe mbështesin kapacitetin ligjor të personave me aftësi të kufizuara "në baza të barabarta me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës së tyre", përfshirë jetën politike, e cila përfshin e drejta për të votuar.

Sipas nenit 12, paragrafi 3 të Konventës, shtetet palë kanë detyrime pozitive për të garantuar për personat me aftësi të kufizuara ushtrimin e kapacitetit ligjor. Prandaj, Komiteti është i mendimit se duke i privuar ankuesit nga e drejta për të votuar, bazuar në një aftësi të kufizuar intelektuale të perceptuar ose faktike, shteti nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 29 të Konventës dhe në lidhje me nenin 12 të Konventës.

Sa i përket vlerësimi individual (i cili është vendimtar për rastin nga GJEDNJ i përshkruar më poshtë, Alajos Kiss kundër Hungarisë) komisioni konstatoi se vlerësimi i kapacitetit të individëve është diskriminues në natyrën e tij, Komiteti konsideron se kjo masë nuk mund të supozohet të jetë legjitime. As nuk është proporcionale me objektivin për të ruajtur integritetin e sistemit politik apo partive politike. Komiteti thekson që, sipas nenit 29 të Konventës, palës shtetërore i kërkohet të përshtatë procedurat e

---

<sup>36</sup> Zsolt Bujdosó and five others (represented by counsel, János Fiala, Disability Rights Center)  
[http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CRPD/Jurisprudence/CRPD-C-10-DR-4-2011\\_en.doc](http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CRPD/Jurisprudence/CRPD-C-10-DR-4-2011_en.doc)



vetimit, duke siguruar që ato të jenë "të përshtatshme, të arritshme dhe të lehta për t'u kuptuar dhe përdorur" dhe duke lejuar aty ku është e nevojshme ndihmë në votim me kërkesë të personit me aftësi të kufizuara. Duke vepruar kështu, Shteti Palë do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara intelektuale të votojnë në mënyrë të barabartë me të tjerët, duke garantuar fshehtësinë e votës.

Në menyrë të përmbledhur mund të thuhet që:

Sipas të drejtës ndërkombëtare

- a) Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën për të votuar në baza të barabarta me qytetarët e tjerë.
- b) Nëse nuk testohet aftësia për të votuar për persona pa aftësi të kufizuara, nuk duhet të testohet as aftësia për të votuar personat me aftësi të kufizuara. Për ta bërë këtë është diskriminuese.
- c) Personave me aftësi të kufizuara duhet t'i sigurohet mbështetje, përshtatje e arsyeshme dhe aksesueshmëri për të siguruar të drejtën e tyre të plotë dhe efektive për të votuar.<sup>37</sup>

### **Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

E drejta për pjesëmarrje në jetën politike është e mirëvendosur në Traktatin e Lisbonës i cili shpall pa kompromis: "Çdo qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në jetën demokratike të Bashkimit".<sup>38</sup>

Në analizën që i bën kufizimeve për të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara, gjykata vlerëson qëllimin dhe proporcionalitetin e kufizimeve të vendosura. Neni 3 i Protokollit 1 nuk përcakton në mënyrë eksplicite kufizimet që mund të vendosen mbi të drejtën e garantuar nga ky nen, në mënyrë që një gamë e gjerë e qëllimeve të mund të jetë në përputhje me nenin 3. Gjykata ka pranuar që në këtë fushë, shtetet kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar se cilat kufizime për të drejtën e votës mund të justifikohen në kohët moderne, dhe nëse kjo ndodh, sa i drejtë është bilanci. Është në duart e legjislativit që të vendosë se cila procedurë duhet të hartohet për të rregulluar të drejtën për të votuar për personat me aftësi të kufizuara mendore. Ajo që bëjnë Gjykatat kombëtare është të kontrollojnë nëse ka dëshmi se legjislativi ka vlerësuar drejt proporcionalitetin e kufizimit në fjalë.

Gjykata vendos që që ndalimi absolut i votimit të personave me aftësi të kufizuara të pjeshme, pa vlerësuar aftësitë e tyre, shtë disproporcionale dhe nuk përfshihet në hapësirën e vlerësimit që kanë shtetet sikur u përmend më lart. Për më tepër, nëse një kufizim i të drejtave themelore zbatohet për një grup social që ka qenë subjekt i diskriminimit në të kaluarën, siç janë personat që vuajnë nga probleme të

<sup>37</sup> Marrë nga komentet e përgatitura nga organizata "Validity" në çështjen Marinov kundër Bullgarisë, apikimi me numër 26081/17. Komentet bazuar në Rregullat e Gjykatës44(3), datë 8 Dhjetor 2017

<sup>38</sup> [http://ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/charter/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/charter/index_en.htm)



shëndetit mendor, shteti do të ketë një diskrecion më të ngushtë për të kufizuar të drejtën në fjalë dhe duhet të ketë arsye serioze për këtë kufizim.

Arsyeja për këtë qasje është se këto grupe të shoqërisë kanë qenë historikisht pjesë e paragjyqimeve që kanë sjellë gjithmonë pasoja negative për ta, duke sjellë përjashtimin e tyre social. Paragjyqimet e tilla mund të rezultojnë në stereotipizimin legjislativ, gjë që pengon vlerësimin individual të kapacitetit dhe nevojave të këtyre individëve.

Gjykata vlerësoi më tej se trajtimi i njëjtë si kategori e njëjtë e personave me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me probleme të shëndetit mendor është një klasifikim i diskutueshëm dhe kufizimi i të drejtave të tyre duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit të rreptë. Heqja e së drejtës për të votuar pa një vlerësim ligjor individual bazuar vetëm në ekzistencën e një aftësie të kufizuar pjesëshe të një individi nuk mund të konsiderohet në përputhje me kufizimet e ligjshme të së drejtës së votës dhe përbën shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

Alajos Kis shënon rastin e parë ku GJEDNJ-ja deklaroi se personat me aftësi të kufizuara janë një grup i mbrojtur sipas KEDNJ-së. Duke vepruar kështu, Gjykata vendosi që shqyrtimi i ardhshëm i kufizimeve të imponuara nga shteti mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si brenda dhe përtej kontekstit të pjesëmarrjes politike, do të kenë një hapësirë e ngushtë vlerësimi. Së fundmi, Kis është rasti i parë në të cilin GJEDNJ në mënyrë eksplicite ka miratuar rëndësinë e KDPAK për t'u angazhuar në çështjen e kujdestarisë ligjore, që mbizotëron në vendet evropiane. Vendimi Kis rrit standardet për zbatimin e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara përtej Evropës. Duke u bazuar tek KDPAK për qasje të barabartë në votim, GJEDNJ vendos detyrimin mbi shtet për të rishqyrtuar të normave dhe praktikave tani të vjetruara<sup>39</sup>.

Megjithëse nuk ka ende një koment për nenin 29, referenca e përgjithshme për nenin 12 të nxjerrë nga Komiteti i CRPD në vitin 2014 nënvizon se "aftësia e vendimarrjes së personit nuk mund të përdoret për të justifikuar përjashtimin e personave me aftësi të kufizuara nga ... e drejta për të votuar."<sup>40</sup>

### **Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecia-s)**

E drejta për të votuar e personave me aftësi të kufizuara mandora është shqyrtuar edhe nga Komisioni i Venecias. Sfidat që ky komision ka hasur flasin qartë edhe për sfidat që hasin gjykatat apo institucionet e ndryshme.

---

<sup>39</sup> The Democratic Life of the Union: Toëard Equal Voting Participation for Europeans with Disabilities J'anos Fiala-Butora, Michael Ashley Stein, Janet E. Lord, 2014

[http://www.harvardilj.org/ëp-content/uploads/2014/03/HILJ\\_55-1\\_Fiala-Butora-et-al.pdf](http://www.harvardilj.org/ëp-content/uploads/2014/03/HILJ_55-1_Fiala-Butora-et-al.pdf)

<sup>40</sup> General Comment No 1 Article 12: Equal recognition before the laë (Adopted 11 April 2014)





Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (i njohur ndryshe si Komisioni i Venecias), është organi këshillues i Këshillit të Evropës për çështjet kushtetuese dhe ka 57 anëtarë nga shtetet në Evropë, Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut dhe Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Në tetor 2010, Komisioni i Venecias miratoi një "Deklaratë Interpretative të Kodit të

Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore për Pjesëmarrjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Zgjedhje" (Deklarata Interpretative).

Paragrafi 2 i Deklaratës Interpretative thotë:

"Asnjë person me aftësi të kufizuar nuk mund të përjashtohet nga e drejta për të votuar ose për të dalë në zgjedhje në bazë të aftësisë së kufizuar fizike dhe / ose mendore të saj, përveç nëse heqja e të drejtës për të votuar dhe për t'u zgjedhur vendoset me vendimin e një gjykate për shkak të aftësisë së kufizuar mendore të provuar".

Deklarata Interpretative sugjeron që Shtetet të miratojnë një rregullore të ngjashme për të drejtën e votës për atë që ekziston në Spanjë. Disa shtete kanë sisteme në të cilat bëhet një vlerësim gjyqësor për aftësinë e një personi për të votuar: për shembull Spanjën, Francën dhe Slloveninë. Ligji në Shtetet e tjera, siç është Republika Çeke dhe Hungaria, duket se po zhvillohet në të njëjtën drejtim. Pas avokimit të shoqërisë civile, Komisioni i Venecias deklaroi se propozoi të ndryshonte paragrafin e mësipërm si më poshtë<sup>41</sup>:

"Votimi universal është një parim themelor i Trashëgimisë Evropiane Zgjedhore. Personat me aftësi të kufizuara nuk mund të diskriminohen në këtë drejtim. Sidoqoftë, gjykata, në një vendim individual, mund të konsiderojë që mungesa e gjykimit të duhur të një personi me aftësi të kufizuar mund ta parandalojë atë që të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar".

Sipas mendimit të Komisionit të Venecias, ky formulim "është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare. Në veçanti, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në nenin 29 të saj, nuk parashikon një të drejtë absolute".

Në maj 2011, u propozua një version i ri, i cili thotë:

"Votimi universal është një parim themelor i trashëgimisë zgjedhore evropiane. Një person mund të përjashtohet nga ushtrimi i të drejtës së tij për të votuar ose për të dalë në zgjedhje në bazë të një vendimi

---

<sup>41</sup> Written submission by the Mental Disability Advocacy Center the Mental Disability Advocacy Center to the Committee on the Rights of Persons with Disabilities to the Committee on the Rights of Persons with Disabilities, Sixth Session 19- Sixth Session 19-23 September 23 September 23 September 2011 With respect to Spain With respect to Spain's implementation of Article 29 of the CRPD

[http://mdac.info/sites/mdac.info/files/EN\\_2011\\_08\\_22\\_shadrep\\_spain\\_a29.pdf](http://mdac.info/sites/mdac.info/files/EN_2011_08_22_shadrep_spain_a29.pdf)

individual të dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, sipas legjislacionit kombëtar, bazuar në argumente objektive dhe të arsyeshme dhe jo vetëm në bazë të aftësisë së kufizuar".

Ndërsa në dhjetor 2011 Komisioni ndryshoi Deklaratën Interpretative duke hequr të gjitha kufizimet. Votimi universal është një parim themelor i Trashëgimisë Evropiane të Zgjedhjeve. Personat me aftësi të kufizuara nuk mund të diskriminohen në këtë drejtim, në përputhje me nenin 29 të KDPAK dhe praktikën gjyqësore të KEDNJ<sup>42</sup>.

### **Komiteti i Ministrave**

Në rekomandimin e tij KM/ Rec (2011) 14 të Komitetit të Ministrave në shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike të diskriminimit në ushtrimin e kapacitetit ligjor.

Duke pasur parasysh Planin e Veprimit për Aftësinë e Kufizuar të Këshillit të Evropës 2006-2015 dhe, sipas nenit 12 "Njohja e barabartë para ligjit" të KDPAK, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që legjislacioni i përgjithshëm nuk diskriminon personat me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike. Ata duhet të garantojnë mbështetjen në dispozicion të personave të cilët mund të kenë nevojë për ndihmë në ushtrimin e kapacitetit të tyre ligjor në aspekte të ndryshme të jetës, në veçanti kur ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar, e cila është një e drejtë universale, në veçanti sipas kushteve të nenit 29 të KDPAK-së dhe në instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare në të cilat shtetet anëtare janë palë. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që legjislacioni i tyre të jetë i lirë në të gjitha nivelet e dispozitave që i privojnë personat me aftësi të kufizuara të drejtën për të votuar ose për t'u kandiduar për t'u zgjedhur.

Të gjithë personat me aftësi të kufizuar, nëse kanë dëmtime fizike, ndijore ose intelektuale, probleme të shëndetit mendor ose sëmundje kronike, kanë të drejtë të votojnë në të njëjtat kushte si qytetarët e tjerë dhe nuk duhet të privohen nga kjo e drejtë nga ndonjë ligj apo me ndonjë vendim gjyqësor. Të gjithë personat me aftësi të kufizuara gjithashtu kanë të drejtë të mbajnë poste në kushte të barabarta me të tjerët dhe nuk duhet të privohen nga kjo e drejtë nga ndonjë ligj apo vendim që kufizon zotësinë e tyre për të vepruar.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar të jetë i ndaluar në të gjitha fushat e jetës politike dhe publike, domethënë kudo që ka çështje votimi, zhvillohen për zgjedhje,

---

<sup>42</sup> [http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2011\)045-e](http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2011)045-e)

<sup>42</sup> [Ibid.](#)

kur mund të ushtrohen mandate dhe kur personat janë aktiv në partitë politike apo organizatat joqeveritare dhe ushtrimin e detyrave publike.<sup>43</sup>

## **V. E DREJTA PËR TË VOTUAR NGA PIKËPAMJA E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**

### **Kushtetuta, legjislacioni dhe dokumentat politike**

Në Republikën e Shqipërisë, ligji i siguron të drejtën e zgjedhjes edhe personave me aftësi të kufizuara, e sanksionuar kjo në Kushtetutën<sup>44</sup> e Republikës së Shqipërisë dhe në Kodin Zgjedhor.

E drejta e votimit të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë për të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë është e sanksionuar në:

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nr.8417, dt.21.10.1998, neni 45, pika 1, 2

“Çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Përrjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paafte mendërisht “.

Kodi Zgjedhor<sup>45</sup> i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

Në Kodin Zgjedhor sanksionohet e drejta e votimit të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë për zgjedhësit me aftësi të kufizuar. Në nenin 108, Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë, përcaktohet se:

1. Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.

2. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

---

<sup>43</sup> [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805cbe4e](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cbe4e)

<sup>44</sup> Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Miratuar me referendum më 22.11.1998 Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007 Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008 Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.09.2012 Ndryshuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015 Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016

<sup>45</sup> Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 2.4.2015.

3. Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.

4. Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

5. Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.

6. Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Regjistrimi si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve.

7. Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.

8. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi Nr. 10 221, datë 04.02.2010, neni 9, 'Pjesëmarrja në politikë' ..., "ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji". Ndër shkaqet që mund të përbëjnë diskriminim të nenit 1, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është dhe aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore.

Udhëzimi i KQZ, Nr.01, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet", kërkon që (a) QV të jenë në katet e para të objekteve; (b) krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuar; (c) dërgimin në KQZ të listës së votuesve me aftësi të kufizuar dhe votuesve të verbër brenda periudhës së rishikimit të ekstraktit të pëbërësve zgjedhorë.

Ligj Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara" dhe Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në



komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, kërkojnë gjithashtu heqjen e barrierrave për të garantuar votim të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, VKM Nr. 483, datë 29.6.2016, në fushën e veprimit ‘Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike’, përcakton si Objektiv 1 mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të votuar, advokuar për interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje.

Konkretisht, i referohemi Kodit Zgjedhor, të miratuar me Nr. 10 019, datë 29.12.2008, azhurnuar me Ligjin Nr. 74/2012, i cili në nenin 108, nenit 44, pika c, dhe nenit 108 të cilët respektivisht rregullojnë çështjet e zgjedhësve, që nuk mund të votojnë vetë dhe përjashtojnë personat pa zotësi juridike për të vepruar. Të dy këto nene, vijnë në kundërshtim me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe me Ligjin për Mbrotjtjen nga Diskriminimi dhe shkaktojnë një situatë diskriminuese për grupin e personave me aftësi të kufizuara mendore: intelektuale apo të shëndetit mendor.

Në Kodin Zgjedhor, në nenin 44, pika c, kriter për përfshirjen në listat e zgjedhësve, ndër të tjera, ka dhe kushtin e mosshpalljes me vendim të formës së prerë si person i pazoti për të vepruar;

Në nenin 108 të Kodit Zgjedhor institucionalizohet termi “zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë”. Termi “zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë” është paragjykes dhe diskriminues ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara janë zgjedhës, njësoj si të gjithë të tjerët. Me përshtatjet e arsyeshme dhe ndryshimet e nevojshme, këta zgjedhës votojnë vetë, në mënyrë të lirë, të drejtpërdrejtë, të fshehtë dhe të pavarur, sipas parimeve në të cilat bazohet Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, si dhe mbi bazën e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Brenda këtij neni, gjithashtu, përcaktohet e drejta për t’u vetë deklaruar si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë, përmes një kërkesë, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin provues. Kodi Zgjedhor, nuk përcakton më tej, se cila duhet të jetë forma e kërkesës, me shkrim apo gojarisht, dhe nëse dokumentet duhet të paraqiten në origjinal, fotokopje e thjeshtë apo fotokopje e noterizuar. Në të gjitha rastet, jemi të mendimit që kjo pikë, vendos edhe një barrë më shumë mbi votuesit, të cilët mund të kenë nevojë për mbështetje gjatë ditës së zgjedhjeve. Kjo, përveçse një barrë e tepërt, nuk është në harmoni dhe me aktet nënligjore ekzistuese. Këtë e themi duke pasur parasysh këtu faktin, që udhëzimet e KQZ, vendosin detyrimin mbi njësitë vendore për identifikimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara dhe marrjen e masave për përshtatshmërinë e qendrave të votimit, apo

mbështetjes së tyre. Në këto kushte, nuk është e nevojshme, që zgjedhësit me aftësi të kufizuara, të paraqesin kërkesa dhe dokumente, që kushtëzojnë njësitë vendore në marrjen e masave për përshtatshmëri të ambienteve ose jo, kur njësitë vendore disponojnë të gjitha listat e personave me aftësi të kufizuara, të cilët marrin pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar apo shërbime të tjera shoqërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një pikë e tillë, nuk vendos një detyrim të qartë mbi njësitë e pushtetit vendor për të përshtatur në çdo rast, ambientet e qendrave të votimit, pra paraqitet si mundësi alternative dhe jo si një detyrim.

Ky nen, nga ana tjetër, edhe pse parashikon disa masa për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe të verbërve, nuk ka parashikime për personat me aftësi të kufizuara mendore (të cilët mund të mos jenë shpallur si të paaftë mendërisht me vendim gjykate të formës së prerë, për rrjedhojë mund të votojnë. Për shkak të mosparashikimeve, nuk kanë procedura apo materiale të përshtatura/të thjeshtuara për llojin e aftësisë së kufizuar që ata kanë. E theksojmë këtë, pasi për personat me vendim gjykate të formës së prerë, Kodi Zgjedhor, e kanë dhënë një ‘zgjidhje’: Ata janë të përjashtuar nga regjistrat zgjedhorë.

Duke pasur parasysh nenin 9 të Ligjit” Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ‘Pjesëmarrja në politikë’ ...” ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t’u zgjedhur dhe për t’u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”;

Ndër shkaqet që mund të përbëjnë diskriminim të nenit 1, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është dhe aftësia e kufizuar, gjendja shëndetësore, duke përfshirë këtu personat me aftësi të kufizuara mendore;

Duke pasur parasysh faktin, që kjo çështje ngrihet për herë të parë për diskutim, në Shqipëri, tre rastet e vetme që kanë të bëjnë me diskriminimin, në ushtrimin e të drejtës për të votuar të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë shqyrtuar pranë KMD u referohen personave me aftësi të kufizuara fizike.

Neni 12, i Konventës është një nga nenet thelbësore për të kuptuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara mendore. Kjo është e njohur si një pikë kthese dhe jemi të mendimit që me ratifikimin e KDPAK nga Shteti Shqiptar, ky është një moment i duhur për të filluar aksione të tilla për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara mendore.

Heqja e së drejtës për të votuar, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë dhe bazohet në një mendësi të vjetruar, që të gjithë personat me aftësi të kufizuara mendore, intelektuale apo të shëndetit mendor, janë të paaftë në shumë fusha apo në çdo fushë.

Në argumentimin në lidhje me dispozitën diskriminuese të Kodit Zgjedhor të RSH, nenin 44, shtojmë se kjo dispozitë, duhet të hiqet nga Kodi Zgjedhor, jo vetëm sepse vjen në kundërshtim me vendimin e GJEDNj dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Nga verifikimet e bëra nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, rezultojnë që në realitet kjo dispozitë ka gjetur zbatim të pjesshëm. Gjatë kontrollit të personave të shpallur si të pazotë për të vepruar, në Fletoret Zyrtare të 7 viteve të fundit, rezultojnë që 70 % e tyre nuk figurojnë të hequr nga listat e zgjedhësve<sup>46</sup>. Pra, në praktikë, këta persona mund të votojnë. Por kjo nuk ndryshon faktin, që kjo

---

<sup>46</sup> Një pjesë e madhe e Fletore Zyrtare nuk janë të disponueshme. Jemi kufizuar, vetëm në ato të cilat ishin të disponueshme në faqen zyrtare të Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Gjithashtu, nuk mund të denim, nëse, personat e shpallur si të paaftë në fletoret Zyrtare, ishin hequr apo nuk gjendeshin në listat elektronike, për shkak të shpalljes si të paaftë, apo për ndonjë shkak tjetër. Është e vështirë të konkludohet, pasi sistemi i koordinimit mes gjykatave dhe institucioneve të tjera lokale, çalon në zbatim. 2013





dispozitë ligjore mbetet diskriminuese dhe përbën bazë ligjore për heqjen e tyre nga listat e zgjedhësve dhe, që kjo dispozitë, si absolute në natyrën e vet, vjen në kundërshtim me vendimin e GJEDNJ dhe KDKPAK.

Në sistemin ligjor shqiptar, zotësia juridike për të vepruar kushtëzohet nga dy karakteristika kryesore: mosha dhe aftësia mendore për të kuptuar pasojat e veprimeve juridike. Heqja e zotësisë juridike për të vepruar, në bazë të kodit të Procedurës Civile, mund të kërkohet nga bashkëshorti, gjini e afërme, prokurorit, si dhe çdo person që ka interes të ligjshëm. Heqja nënkupton një vdekje civile për personin në fjalë, pasi të gjitha veprimet do të kryhen nga kujdestari ligjor, i cili caktohet automatikisht me heqjen e zotësisë juridike për të vepruar.

Është e qartë se, heqja e zotësia juridike për të vepruar ka impakt në jetën e përditshme dhe në vendimet apo veprimet juridike që kryejnë ose mund të kryejnë personat me aftësi të kufizuara mendore. Ky impakt negativ, shtrihet edhe në të drejtën për të votuar të personave me aftësi të kufizuara mendore. Është e qartë, që me ratifikimin e KDKPAK, Shteti Shqiptar, angazhohet/ ka detyrimin për të përqasuar legjislacionin kombëtar me atë të KDKPAK.

Në lidhje më këtë, KDKPAK, prezanton në vend të heqjes së zotësisë juridike për të vepruar dhe vendosjes nën kujdestari ligjore, modelin e mbështetjes në vendimmarrje. (neni 12, pika 3)

Jemi të mendimit, që duke filluar me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e votës, të konsideruar si një e drejtë, parakusht për realizimin e të gjithë të drejtave të tjera, mund të vazhdohet më tej me reformimet përkatëse në fusha të tjera.

Në nenin 45 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë (RSH) sanksionohet e drejta për të votuar e të gjithë shtetasve shqiptarë, të cilët kanë mbushur moshën për të votuar, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, dhe që nuk janë shpallur të paafte mendërisht me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kushtetuta e RSH u referohet personave të paafte mendërisht me një terminologji të vjetruar, paragjyquese dhe diskriminuese për këtë kategori.

Nën dritën e ndryshimeve të reja, duke pasur parasysh këtu KDKPAK dhe vendimet e fundit të GJEDNJ, tashmë nevojiten disa ndërhyrje në Kushtetutë dhe në ligjet e tjera.

Neni 45, pika 2 e Kushtetutës së RSH, është një dispozitë, e cila nuk bën dallime mes llojeve të ndryshme të aftësive mendore. Ajo bazohet ekskluzivisht vetëm te aftësia e kufizuar mendore, dhe për pasojë, është diskriminuese ndaj kësaj kategorie. Jemi të ndërgjegjshëm, që Kodi Zgjedhor, bazohet në nenin 45, pika 2, të Kushtetutës së RSH dhe tenton që të rregullojë praktikën zgjedhore për të reflektuar pikërisht këtë nen, prandaj dhe domosdoshmërisht, ndërhyrja duhet adresuar në Kushtetutë.

Jemi të mendimit që neni 108, neni thelbësor në sigurimin e votimit nga ana e personave me aftësi të kufizuara (PAK), fillimisht duhet të rregullojë, parimisht dhe qartësisht çështjen e përshtatshmërisë së qendrave të votimit dhe të procedurave të votimit. Ky duhet të jetë rregull i parësor dhe standart në votimin e PAK. Nëse rregullohet dhe përforcohet zbatimi i këtij neni, përdorimi i metodave të tjera alternative (që rezultojnë tanimë, të dosmodoshme) do të ulej në mënyrë të konsiderueshme, duke



passjellë votimin e personave me aftësi të kufizuar në kushte të barabarta me të tjerët dhe për më tepër në mënyrë dinjitoze.

Kështu neni 29, Shtetet Palë duhet t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër: (a) T'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mpjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke: (i) Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur.

Ajo çka vlen të theksohet, është se KDPAK, nuk kërkon vetëm një mundësi formale votimi por vendos detyrimin për realizimin e plotë, efektiv dhe në kushte të barabarta me të tjerët.

Duke rregulluar nenin kryesor, 108, me detyrimin e qartë për të përshtatur qendrat e votimit dhe procedurat për votimin e PAK, reflektojmë detyrimin e ndërmarrë nga shtetit Shqiptar, përmes ratifikimit të KDPAK. Duke qënë se KDPAK vendos detyrimin për të siguruar përshtatshmërinë,

thënë kjo në terma të përgjithshëm, përmes këtij neni duhet të sqarohen hapat dhe masat konkrete, që duhen ndërmarrë nga institucionet, përgjegjëse, tashmë të përcaktuara prej kohësh në Kod, duke ndjekur një rrjedhë logjike, e cila qartëson dhe lehtëson dhe përcakton institucionet përgjegjëse për të vënë në zbatim nenin e mësipërm.

Kështu, institucionet përgjegjëse mbeten njësitë e pushtetit vendor. Duke qënë se, këto institucione kanë pasur historikisht detyrimin në lidhje me administrimin e qendrave të votimit dhe duke pasur parasysh, që këto njësi sipas legjislacionit në fuqi, kanë detyrimin të administrojnë dhe të kryejnë të gjitha pagesat për personat me aftësi të kufizuara, pra kanë të gjithë listë pagesat dhe njohin konkretisht situatën e familjeve nën njësinë e tyre vendore, ato janë plotësisht të afta për të identifikuar në njësitë e tyre dhe llojet e aftësive të kufizuara që ata kanë. Nga ana tjetër, gjatë zgjedhjeve të vitit 2013, KQZ i kërkoi këtyre njësive, që të dorëzonin pranë kësaj të fundit listat e personat me aftësi të kufizuara, lista të cilat u dërguan në KQZ, me qëllim realizimin e përshtatshmërive të ndryshme për kategori të ndryshme.

Në nenin aktual, ka një parashikim për kryerjen e kërkesave nga ana e personave me aftësi të kufizuar, me qëllim lehtësimin e votimit ditën e votimit. Kjo kërkesë, përveçse nuk është e njohur, duhet bërë në një kohë shumë të largët nga data e zgjedhjeve, çka bën që personat mos ta shfrytëzojnë këtë opsion, ashtu siç tregon praktika. Kjo kërkesë gjithashtu përbën një barrë në kuptimin e personave me aftësi të kufizuar, të cilët duhet të paraqesin dokumentë që provojnë aftësinë e kufizuar njësisë bashkiake, e cila tashmë e njeh këtë status të personit.

Kërkesa, jemi të mendimit, duhet të drejtohet pranë njësive të pushtetit vendor, vetëm në rastet e kërkesave për përshtatje të arsyeshme (staf mbështetës, pajisje, transport ditën e votimit etj.) apo për votim nga shtëpia, kërkesa të cilat nuk mund të njihen nga njësitë e pushtetit vendor.





Është lënë vetëm termi përshtatje të arsyeshme, duke patur parasysh, që ky koncept është i sqaruar në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu FSHDPAK ka disa materiale sqaruese mbi këtë koncept. Ai duhet të jetë subjekt i trajnimeve dhe I manualeve të KQZ-së.

Nga ana tjetër, këto njësi janë plotësisht të afta që të identifikojnë qendrat e votimit në njësitë e tyre dhe të identifikojnë vetë apo me asistencë, nivelin e përshtatshmërisë së këtyre qendrave: përshtatshmëri në infrastrukturë kryesisht, rampa, dyer të gjera, ambejnte ku mund të lëvizin karrocet me rrota apo me persona me paterica, dhoma të fshehta të përshtatura (në nivel karroce me rrota), formate Braille) etj.

Duke pasur një numrin e personave me aftësi të kufizuara dhe llojet, dhe duke bërë një krahasim mes qendrave ekzistuese, bëhet i mundur identifikimi i nevojave për ndërhyrje, identifikim ky, i cili i shërben buxhetimit, në kohën dhe në nivelin e kërkuar prej tyre.

Pra, hapat e parë kanë të bëjnë me identifikimin e personave dhe qendrave ku ata votojnë, dhe më pas, në bazë të gjetjeve në këtë fazë, paraqiten (është përdorur fjala koordinim me KQZ (mund të ndryshohet) në nenin 1 pika d) hartojnë kërkesat për KQZ, në mënyrë që KQZ të bëjë buxhetimin përkatës mbi bazën e kërkesës. Rregullat e përgjithshme të buxhetimit duhet të gjejnë zbatim dhe këtu.

Duke qënë se personat me aftësi të kufizuara mund të kenë probleme me votimin vetë dhe për rrjedhojë kanë nevojë të jenë të asistuar, që nga momenti i ardhjes në qendrën e votimit dhe përgjatë gjithë procesit të tyre të votimit, deri me daljen nga qendra e votimit, rregullohen (sic në dispozitat ekzistuese, pa ndryshime të mëdha) procedurat e votimit përmes asistentit. Kjo procedurë është një praktikë, e cila shprehet në KDPAK: neni 29, pika (iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistencë në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.

Në nenin 2, duke qënë se në bazë të formulimit të vjetër, zgjedhësi me aftësi të kufizuara përfshinte vetëm ...”zgjedhës që për arsye fizike”...u ndryshua me...zgjedhës me aftësi të kufizuara, për të zgjeruar rrethin e përfituesve (mund të jenë persona me problem të lehta fizike, mendore apo në shikim, të cilët kanë nevojë për asistencë në një shkallë të vogël dhe kjo asistencë duhet të jepet ditën e votimit deri në shkallën dhe masën e nevojshme, gjithmonë duke ndjekur procedurat e parashikuara në këtë nen për asistencën)

Një tjetër adresim i rëndësishëm, është edhe përfshirja e personave në moshë të avancuar, të cilët, deri në një farë mase përjetojnë aftësi të kufizuara, të llojeve të ndryshme. Këta persona, janë persona të cilët nuk kualifikohen nga skemat aktuale sociale, si persona me aftësi të kufizuara por nga ana tjetër, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore, plotësojnë kushtet për të t'u asistuar sipas dispozitave të këtij, që shtrihen mbi PAK. Nëse personat në moshë të avancuar kërkojnë të votojnë sipas pikës 8, (a) dhe (b) ata duhet të provojnë sëmundjen me anë të një dokumenti zyrtar, gjatë dorëzimit të kërkesës në njësinë vendore.



Është e rëndësishme të nënvizohet, që detyrimi i parë, që kanë njësitë vendore, ka të bëjë me sigurimin e përshtatjes së qendrave të votimit, për adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo është mënyrë e plotë, efektive dhe në kushte të barabarta me të tjerët.

Përveç kësaj mënyre, ky nen siguron dhe zgjidhjet alternative, të cilat janë:

E para, votimi nga banesa, për të gjithë ata persona, të cilët nuk mund të lëvizin nga shtëpitë tyre, për shkak të mungesës së theksuar të aksesibilitetit ambjentet ku jetojnë dhe ku votojnë;

E dyta, duke siguruar lehtësim përmes sigurimit të përshtatjeve të arsyeshme (Refero Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe rekomandimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në tre rastet e shqyrtuara prej tij. Këtu mund të përfshihen: Staf mbështetës për personat që kanë nevojë për mbështetje ditën e votimit, transport të siguruar (që rezulton ndër praktikat më të mira në shumë vende, pajisje të ndryshme asistive)

Institucionet kanë detyrë të zbatojnë legjislacionin ekzsitues për përshtatshmërinë dhe marrin ex officio të gjitha masat për ta realizuar atë. Ndërkohë, që për të votuar përmes dy mënyrave të tjera alternative, individët, kanë detyrimin për të kërkuar paraprakisht pranë njësisë vendore, votimin përmes një nga dy alternativave të ofruara në Kod.

Një tjetër, mënyrë alternativë, është dhe opsioni për të ndryshuar qendrën e votimit, nga vetë njësia për person me aftësi të kufizuara, kur ajo gjatë procesit së identifikimit të nivelit të përshtatshmërisë, ajo vë re, që qendra është e pamundur të përshtatet, për arsye të ndryshme (teknike, infrastrukurore). Njësia vendore ka detyrimin për të informuar në kohë, të gjithë PAK, të cilëve i ndryshohet qendra e votimit.

Në lidhje me sanksionet, që vendosen, është shtuar një pikë për sanksionet. Një ndërhyrje, që mund të konsiderohet më e mirë dhe më e përfuruar, do të ishte shtimi i parashikimit për sanksione në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Kjo, për të mos ia lënë trajtimit të përgjithshëm të sanksioneve, që u vendosen drejtuesve të institucioneve për moszbatim të dispozitave të këtij kodi apo për mungesë bashkëpunimi me KQZ-në. Duke shtuar një pikë të veçantë, siç ekziston në rastin e barazisë gjinore aktualisht, mund të vendosen dhe sanksione më të rrepta, duke pasur parasysh, që ky nen nuk është zbatuar asnjëherë në nivelet apo mënyrat e kërkuara prej tij.

Është shtuar gjithashtu pika 12, e cila parashikon në mënyrë specifike trajnime mbi temën e aftësisë së kufizuar. Kjo pasi, derimëntani, neni ekzsitues është interpretuar dhe zbatuar në mënyrën jo të duhur si nga KZAZ dhe si nga njësitë vendore dhe çështjet e aftësisë së kufizuar nuk janë trajtuar si duhet. Njohja e nenit të vjetër ka qënë në nivele të ulta dhe amendimet e reja duhen patjeter bërë të qarta dhe të interpretohen në frymën e KDPAK dhe në zbatim të parimeve të këtij kodi. Duke pasur parasysh rekomandimet gjatë tryezës së përbashkët, u shtua dhe neni 13, që parashikon bashkëpunimin me organizatat. Gjithashtu janë shtuar përgjatë gjithë nenit disa pika, duke pasur si pikënisje reflektimin e rekomandimeve të dala nga ky dokument rekomandues. Këto dy pika mund të qëndrojnë ose mund të rregullohen me marrëveshje të veçanta mes tyre. Por këtu duhet theksuar, që KDPAK vendos detyrimet mbi shtetet palë për të bashkëpunuar me organizata me interesa legjitimë.

## **VI. PËRFUNDIME**

Votimi është një komponent thelbësor i një demokracie përfaqësuese, por edhe një akt themelor i shtetësisë dhe një simbol i përkatësisë në një komunitet politik. Shumica e shteteve në të gjithë botën vazhdojnë të mohojnë të drejtën për të votuar për personat me aftësi të kufizuara mendore, të cilat janë të paligjshme sipas ligjit ndërkombëtar, është një qasje e vjetëruar, e cila nuk mund të mbështetet më nga argumente racionale. E drejta e votimit garantohet nga një numër

instrumentesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe KDKPAK bën të qartë se e drejta për të votuar duhet të ushtrohet pa përjashtim në bazë të aftësisë së kufizuar mendore.

Historikisht të drejtën për të votuar, për shtetësinë, pronën etj. u është mohuar shumë grupeve, të cilat kanë qënë të marginalizuara në shoqëri, si gratë, afroamerikanët, skllëvërit dhe personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa e drejta për pjesëmarrje politike dhe e drejta e votës në mënyrë specifike ka përparuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve, për personat me aftësi të kufizuara mendore nuk është përmirësuar me të njëjtin ritëm si për grupet e tjera. Një nga arsyet, është se diskriminimi, mosrespektimi dhe mospërfillja kanë qënë të rrënjosura thellë në shoqëri gjë që e bëri komunitetin e personave me aftësi të kufizuara mendore në mënyrë specifike edhe më të prekshme dhe të pafuqishme. Ndërkohë të gjitha kategoritë e tjera të aftësisë së kufizuar kanë fituar të drejtat e tyre përmes protestave ose përmes fuqisë së negociatave, personat me aftësi të kufizuara mendore nuk e kanë këtë shans.

Kjo është arsyeja pse avancimi i së drejtës për të votuar, si i shumë të drejtave të tjera është më i ngadalshëm. Dokumenti tregon se Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka filluar qartë të ndryshojë qasjet. Hapat e parë të ndërmarrja duket të jenë reformat ligjore lidhur me shfuqizimin e dispozitave ekzistuese që heqin të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara mendore bazuar në aftësinë e kufizuar.

Ky ndryshim po vjen më shumë nga avokimi i komunitetit, sesa nga vendimet e gjykatave. KEDNJ-ja ka dështuar në rastin e saj për të trajtuar çështjen e kapacitetit ligjor dhe të drejtën për të votuar, nuk e ka parë atë si një diskriminim të bazuar në aftësitë e kufizuara mendore. Përkundër këtij dështimi, KEDNJ ka bërë disa njohje shumë të rëndësishme në lidhje me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara dhe ka krijuar masa të forta mbrojtëse lidhur me të drejtën për të votuar. Nga ana tjetër, komunikimi i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si organ kompetent autoritar në interpretimin e dispozitave të KDKPAK-së, ka nxjerrë një vendim, i cili në mënyrë të qartë pranon se kufizimet e vendosura mbi të drejtën e votës në bazë të aftësisë së kufizuar janë diskriminuese dhe kundër KDKPAK-së.

Të dy vendimet nuk janë tërësisht në kundërshtim me njëri-tjetrin, por ndërsa GJEDNJ lejon vlerësimin e rregullave sipas rastit dhe lejon kufizimin e të drejtës për të votuar bazuar në vlerësimin, i dyti nuk lejon asnjë vlerësim, i cili në natyrën e tij do të ishte diskriminuese, sepse ajo u drejtohet vetëm personave me



aftësi të kufizuara. Siç u përmend më lart, shumë shtete të bazuara në këto dy vendime kanë filluar reformat e tyre ligjore dhe nuk janë duke pritur për proceset gjyqësore strategjike, siç ishte rasti i Alajos Kiss kundër Hungarisë për të ndryshuar kushtetutat e tyre dhe kodet e tyre zgjedhore.

Megjithatë, pa reformën e legjislacionit të kapaciteteve ligjore, e drejta për të votuar mbetet gjithmonë e cunguar. Reforma ligjore e kapacitetit ligjor është reforma më sfiduese që KDPAK sjell në shtetet që e kanë ratifikuar atë, sepse kërkon nga e gjithë shoqëria të ndryshojë mendësinë rreth aftësisë së kufizuar mendore, ajo kërkon një ndryshim të vërtetë social që mund të ndodhë vetëm pas shumë vitesh. Reforma ligjore mbetet vetëm hapi i parë dhe me siguri do të çojë në ndryshim, por paralelisht me reformat ligjore janë shumë të nevojshme trajnimet dhe njohje më e mire dhe e thelluar e aftësisë së kufizuar mendore, të cilat mund të lejojnë më tej të masa apo veprime konkrete dhe të përshtatshme, duke përfshirë këtu edhe kuadrin ligjor.